



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

THIRRJE PUBLIKE

Duke u bazuar në "Rregullore MF – NR – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve", Komuna e Klinës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

Thirrje publike – për mbështetje financiare për vitin 2026, për të gjitha organizatat joqeveritare, klubet sportive dhe individë që veprojnë në komunën e Klinës, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Data e hapjes së thirrjes 10.03.2026

Afati i fundit për aplikim 30.03.2026

- 1 Me anë të thirrjes publike nga Komuna e Klinës, DKRS synon të mbështes OJQ- të dhe individët nga fusha e rinisë, kulturës dhe sportit, varësisht prej konkurrimit dhe plotësimit të kriterëve me shumë totale 81.000€.
- 2 OJQ-të dhe individët të cilët aplikojnë, obligohen që projekt-propozimet t'i bëjnë në përputhje me aktivitete që realizon Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe t'i zhvillojnë në bashkëpunim të plotë me komunën. Këto projekte mund të përfshijnë aktivitete si në vijim

- **KATEGORIA I - Në fushën e kulturës, ku synohet:**

- Promovimi, afirmimi dhe rritja e aktiviteteve që vë në pah vlerat kulturore
- Promovimi i objekteve me rëndësi të veçantë të Trashëgimisë Kulturore
- Zhvillimi i krijimtarisë artistike në fusha të ndryshme arti
- Realizimin e festivaleve, koncerteve, manifestimeve, ekspozitave, promovimeve, botime të librave dhe shënimin e datave të rëndësishme historike.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga kategori për projekte nga OJQ- të është 1000€ ndërsa shuma maksimale 10000 €.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga kategoria për projekte nga individët është 500€ ndërsa shuma maksimale 3000€.

- **KATEGORIA II - Në fushën e rinisë, ku synohet:**

- Zhvillim i aktiviteteve rinore dhe fuqizimi i të rinjve
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Rinisë
- Mobilizimi i të rinjve në realizimin e projekteve që ndikojnë në sigurinë, mbrojtjen e të drejtave, informacionin dhe aftësimin e të rinjve ndaj dukurive negative shoqërore
- Mbështetje e qendrave rinore dhe grupeve rinore që veprojnë në Komunën e Klinës
- Trajnime, konferenca e sesione informuese që ndihmojnë drejtimin në karrierë.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga kategoria II për projekte nga OJQ- të është 500€ ndërsa shuma maksimale 8000€.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga kategoria për projekte nga individët është 500€ ndërsa shuma maksimale 1000€.

- **KATEGORIA III - Në fushën e sportit, ku synohet:**

- Aktivizimi i sportistëve të rinj e të talentuar
- Përkrahja, ngritja e nivelit profesional dhe zhvillimi i klubeve sportive
- Organizimi i turneve për data të ndryshme historike
- Përfaqësim i Komunës së Klinës në gara sportive kombëtare e ndërkombëtare.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga kategoria III për projekte nga OJQ- të është 500€ ndërsa shuma maksimale 40.000€.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga kategoria për projekte nga individët është 500€ ndërsa shuma maksimale 5000€.

3 Kriteret e përgjithshme për OJQ:

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat e nenit 10 të rregullores MF-04/2017:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga

burimet publike të financimit;

- Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

4 Kriteret e përgjithshme minimale për individët:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Në rast se individ ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e kulturës dhe rinisë si nga kategoria I dhe II të listuara për mbështetje në këtë thirrje, me përvojë të dëshmuar në këto fusha nëpërmjet dshmive të aktiviteteve dhe CV-së.
- Projektet e pranueshme duhet të përmbajnë aktivitete që ndihmojnë në fushën e artit dhe të kulturës, si dhe në fushën e rinisë si mbështetje e grupeve të marginalizuara në Komunën e Klinës.

5 Kriteret specifike për OJQ dhe individ:

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- Të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe Manualit për zbatimin e kësaj Rregulloreje.
- Të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e projekteve/programeve të ngjashme duke

siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën

- Të paraqesin leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike
- Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

6 Mënyra si të aplikoni dhe dokumentet e nevojshme sipas nenit 10 - Kriteret e përgjithshme të rregullores MF04/2017:

- Formulari i projektit për OJQ apo për individ – Formulari 9
- Formulari i buxhetit - Formulari 10
- Deklaratë mbi financimin e dyfishtë – Formulari 11
- Deklaratë e partneritetit (në rast që aplikohet) – Formulari 12
- Dokumenti identifikues (kopje)
- Certifikatë që dëshmon për regjistrimin e OJQ-së në Ministrinë e Administratës (kopje)
- Certifikatë e numrit fiskal (kopje) – të jetë me seli në Klinë, nëndegën në Klinë
- Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
- Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik).

7 Formularët për aplikim i gjeni në web-faqen e Komunës së Klinës.

8 Komisioni vlerësues dhe mënyra e vlerësimit

- Në përputhje me rregulloren, komisioni vlerësues do të përbëhet nga pesë anëtarë.
- Vlerësimi bëhet nga plotësimi i kushteve administrative të aplikimit.
- Ndërlidhja me objektivat e thirrjes.
- Kapaciteti i dëshmuar organizativ dhe udhëheqës.
- Mbështetja financiare e klubeve sportive do të bëhet sipas pjesëmarrjes së tyre në nivelet garuese.
- Vazhdimësisë së realizimit të programit dhe qëndrueshmërisë së tij.
- Raporti i komisionit vlerësues mbi raportet financiare të OJQ-ve për subvencionim në vitin e kaluar.

Vërejtje:

- Gjatë kohës kur thirrja është e hapur, OJQ-të e interesuara mund të kërkojnë sqarime përmes postës elektronike dhe informacione shtesë përkitazi me thirrjen, por jo më vonë se tetë (8) ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.
- OJQ-të dhe individët kanë të drejtë të aplikojnë vetëm me një projekt.
- Periudha e zbatimit për projektet përfituese është deri më 30.03.2026
- Afati i aplikimit është 15 ditë pune nga dita e shpalljes.
- Aplikacionet e plotësuara duhet të dorëzohen personalisht nga aplikuesi, të jenë të vendosura në zarf dhe të regjistrohen në arkiv (zyra pritëse).

Njoftim për aplikuesit:

1. Të gjithë aplikuesit, aplikimet e të cilëve hyjnë në procesin e vlerësimit do të informohen në lidhje me vendimin e ndarjes buxhetore për projektet e pranuar.
2. Të gjithë aplikuesit, aplikimet e të cilëve nuk kanë qenë të kompletuara dhe refuzohen, do të informohen për arsyen e refuzimit në përputhje me kriteret e kërkuara dhe rregulloren.

10-451-7050/26

Klinë, 10.03.2026

